

Kuptimi i Devotshmërisë

ndaj Allahut dhe frytet e saj

Shejkh Salih el-Fewzan



سلفي

SELEFI.ORG

Kurani dhe Suneti sipas kuptimit të Selefëve të këtij Umeti

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Hutbeja e parë:

Lavdërimi i takon Allahut, Zotit të botëve. E lavdëroj Atë me lavdërimi të shumta, të sinqerta e të begata, ashtu sikurse do dhe kënaqet Zoti ynë. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, të Vetëm pa ortak. Të Tij janë emrat më të mirë. Gjithashtu, dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij, Pejgamberi i zgjedhur, lëvdata dhe shpëtimi i madh i Allahut qoftë mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij, si dhe mbi atë që e ndjek Sunetin e tij dhe udhëzohet me udhëzimin e tij.

E më pas:

O ju njerëz, frikësojuni Allahut të Lartësuar dhe mësoni kuptimin e devotshmërisë (frikës ndaj Allahut). Allahu i Patëmeta dhe i Lartësuar ka thënë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ ۚ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ مُسْلِمُونَ﴾ 

“O ju të cilët keni besuar frikësojuni Allahut me një frikë të vërtetë, dhe mos vdisni vetëm se duke qenë Muslimanë”.¹

Gjithashtu, i Patëmeta dhe i Lartësuar ka thënë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا ۚ يُصْلِحْ لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ ۗ وَاللَّهُ يَطِيعُ ٱرْسُولَهُ ۚ فَقَدْ فَازَ فَوْزًا عَظِيمًا﴾ 

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا ۚ يُصْلِحْ لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ ۗ وَاللَّهُ يَطِيعُ ٱرْسُولَهُ ۚ فَقَدْ فَازَ فَوْزًا عَظِيمًا﴾ 

“O ju të cilët keni besuar frikësojuni Allahut dhe thoni fjalë të drejta. Ai ua përmirëson veprat tuaja dhe ju fal juve gjynahet tuaja. Ai i cili i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, vërtet ka fituar një fitore të madhe”.²

¹ Ali Imran, 102.

² El-Ehzab, 70-71.

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَلْتَنْظُرْ نَفْسٌ مَّا قَدَّمَتْ لِغَدٍ ۖ وَاتَّقُوا اللَّهَ ۚ إِنَّ اللَّهَ خَبِيرٌ بِمَا

تَعْمَلُونَ﴾

“O ju të cilët keni besuar frikësojuni Allahut dhe të shikojë njeriu se çfarë ka përgatitur për të nesërmen. Frikësojuni Allahut, vërtet Allahu di gjithçka që ju veproni”.³

Allahu i ka urdhëruar të gjithë krijesat që t’i frikësohen Atij, të parët dhe të fundit. I Lartësuari ka thënë:

﴿وَلَقَدْ وَصَّيْنَا الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ مِنْ قَبْلِكُمْ وَإِيَّاكُمْ أَنْ اتَّقُوا اللَّهَ ۚ﴾

“Me të vërtetë, Ne i patëm porositur ata, të cilëve u ishte dhënë libri para jush, po ashtu edhe juve: që t’i frikësoheni Allahut”.⁴

﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ﴾

“O ju njerëz frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi juve nga një njeri i vetëm”.⁵

Ai urdhëroi besimtarët për frikë ndaj Allahut në veçanti, ashtu sikurse është në ajete që disa prej tyre i dëgjuat, si dhe urdhëroi për të (frikën ndaj Allahut) Pejgamberin e Tij – Lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të. Allahu i Patëmeta ka thënë:

﴿يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ اتَّقِ اللَّهَ وَلَا تُطِعِ الْكَافِرِينَ وَالْمُنَافِقِينَ ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلِيمًا حَكِيمًا﴾

³ El-Hashr, 18.

⁴ En-Nisa, 131.

⁵ En-Nisa, 1.

“O ti Pejgamber, frikësoju Allahut dhe mos iu bind mosbesimtarëve dhe hipokritëve. Me të vërtetë Allahu është i Gjithëditur, i Urtë”.⁶

Ai urdhëroi për devotshmëri të gjithë njerëzit, individët, i urdhëroi të gjithë krijesat që t’i frikësohen Allahut të Patëmeta e të Lartësuar. Ai njoftoi se devotshmëria është furnizimi më i mirë për jetën tjetër. I Lartësuari ka thënë:

﴿وَتَزَوَّدُوا فَإِنَّ خَيْرَ الزَّادِ التَّقْوَىٰ﴾

“Dhe furnizohuni, se me të vërtetë furnizimi më i mirë është devotshmëria”.⁷

Devotshmëria është fjalë përmbledhëse e veprave të mira, të cilat kryhen me fjalë, me vepra, me besim dhe me nijet. Ajo përfshin të gjitha veprat e robit, të dukshmet dhe të padukshmet. Ai e ka obligim që t’i frikësohet Allahut për veprat e tij; t’i frikësohet Allahut për obligimet që ai ka ndaj Allahut, duke përmbushur obligimet që Allahu i ka obliguar atij dhe duke braktisur ndalesat e Tij. T’i frikësohet Allahut për obligimet që ka ndaj Tij. Pra, ta adhurojë Allahun sikur e shikon Atë, e nëse ai nuk e shikon Atë, atëherë le ta dijë se Allahu e shikon atë (*robin*). Pra, t’i përmirësojë veprat dhe t’i frikësohet Zotit të tij në të gjitha situatat. I Dërguari i Allahut – *Lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – ka thënë:

اتَّقِ اللَّهَ حَيْثُمَا كُنْتَ

“Frikësoju Allahut kudo që të jesh”.

Pra, t’i frikësohet Zotit të tij në çdo vend, t’i frikësohet Zotit të tij në çdo gjendje, në kohë të mira dhe të këqija.

Fjalët e Selefëve për komentimin e devotshmërisë janë të ndryshme, porse ato bashkohen në një kuptim: zbatimi i urdhrave të Allahut të Lartmadhëruar duke synuar shpërblimin e Tij dhe braktisja e ndalesave duke pasur frikë prej ndëshkimit të Tij. Për këtë arsye i Lartësuari ka thënë:

⁶ El-Ehzab, 1.

⁷ El-Bekareh, 197.

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تُقَاتِهِ﴾

“O ju të cilët keni besuar frikësojuni Allahut me një frikë të vërtetë”.⁸

Selefët (për komentimin e ajetit) **“Frikësojuni Allahut me një frikë të vërtetë,”** kanë thënë: që t’i bindesh Atij dhe të mos kundërshtohet Ai, të përkujtohet dhe të mos harrohet, të falenderohet dhe të mos mohohet, ky është kuptimi i Fjalës **“me një frikë të vërtetë”**.

Nuk ka dyshim se njeriu është i ekspozuar ndaj rënies në gabim dhe ndaj rënies në kundërshtime. Për këtë arsye, kur zbriti ky ajet: **“O ju të cilët keni besuar frikësojuni Allahut me një frikë të vërtetë”**, Muslimanëve u erdhi rëndë dhe thanë se cili prej nesh mund ta bëjë këtë? Cili prej nesh i frikësohet Allahut me frikë të vërtetë dhe nuk bën ndonjë gabim apo ndonjë shkelje apo ndonjë pakujdesi? Atëherë, Allahu i Patëmeta dhe i Lartësuar zbriti ajetin:

﴿فَاتَّقُوا اللَّهَ مَا اسْتَطَعْتُمْ﴾

“Frikësojuni Allahut aq sa të keni mundësi”.⁹

Pra, ky ajet **“Frikësojuni Allahut aq sa të keni mundësi”** shpjegoi Fjalën e Tij **“me një frikë të vërtetë”**. Andaj që, kush i frikësohet Allahut sipas mundësisë së tij, ai i është frikësuar Allahut me një frikë të vërtetë.

﴿لَا يُكَلِّفُ اللَّهُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا﴾

“Allahu askënd nuk e ngarkon përtej mundësive të veta”.¹⁰

⁸ Ali Imran, 102

⁹ Et-Tegabun, 16.

¹⁰ El-Bekareh, 286.

﴿رَبَّنَا لَا تُؤَاخِذْنَا إِن نَّسِينَا أَوْ أَخْطَأْنَا﴾

“O Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë (pa qëllim)”.¹¹

Allahu i Lartmadhëruar tha: Me të vërtetë e kam bërë atë (d.m.th që nuk do t'i dënoj ata nëse harrojnë ose gabojnë pa qëllim). Kështu që, kush i frikësohet Allahut sipas mundësisë së tij, ai i është frikësuar Allahut me një frikë të vërtetë. Dhe kjo është lehtësim prej Allahut dhe ulje e vështirësisë për robërit e Tij.

Ali ibën Ebi Talib – Allahu i Lartësuar qoftë i kënaqur me të – prijësi i Muslimanëve, ka thënë:

“Devotshmëria është frika ndaj të Madhërishmit, të punuarit me atë që ka zbritur Allahu dhe përgatitja për udhëtimin”.

Andaj që, kush e vepron atë, ai i është frikësuar Allahut me një frikë të vërtetë. “Frika ndaj të Madhërishmit” e Ai është Allahu i Patëmeta e i Lartësuar. “Të punuarit me atë që ka zbritur Allahu”, ai është Libri (Kur’ani) dhe Suneti, “dhe përgatitja për udhëtimin”, nga kjo botë për në botën tjetër e cila bëhet me vepra të mira. Dhe kjo është ngjashme me Fjalën e Tij, të Lartësuarit:

﴿وَتَزَوَّدُوا فَإِنَّ خَيْرَ الزَّادِ التَّقْوَى﴾

“Dhe furnizohuni, se me të vërtetë furnizimi më i mirë është devotshmëria”.¹²

لَعَمْرِكَ مَا السَّعَادَةُ جَمَعَ مَالٍ

Pasha Dhuruesin e jetës tënde, nuk është lumturia mbledhja e pasurisë

¹¹ El-Bekareh, 286.

¹² El-Bekareh, 197.

ولكن التقي هو السعيد

Por i devotshmi, ai është i lumtur

وتقوى الله خير الزاد ذخراً

Frika ndaj Allahut është furnizimi më i mirë për depozitim

وعند الله للأتقى مزيد

E tek Allahu për më të devotshmit më tepër ka shpërblim

Pra, le të jetë parulla e Muslimanit përherë dhe gjithmonë frika ndaj Allahut, në kohë të mira dhe të këqija, në vetmi dhe në prani të njerëzve. T'i frikësohet Allahut përherë dhe gjithmonë, ta braktisë atë që Allahu ia ka ndaluar, dhe ta kryejë atë për të cilën Allahu e ka urdhëruar. Të shtojë pendimin dhe kërkimin e faljes për mangësitë që lë. Kjo është frika ndaj Allahut të Patëmeta e të Lartësuar. Muslimani duhet ta ndjejë atë përherë dhe gjithmonë në të gjitha situatat e tij, në kohë të mira dhe të këqija, në rehati dhe në vështirësi, t'i frikësohet Allahut në vetmi dhe në praninë e tij me njerëzit. Kur i thuhet atij: kije frikë Allahun, atëherë atij i dridhet kraharori nga frika e Allahut të Patëmeta e të Lartësuar, ky është i devotshmi.

Ndërsa, i mjerë është ai siç ka thënë Allahu i Lartmadhëruar:

﴿وَإِذَا قِيلَ لَهُ اتَّقِ اللَّهَ أَخَذَتْهُ الْعِزَّةُ بِالْإِثْمِ فَحَسْبُهُ جَهَنَّمُ وَلَبِئْسَ الْمِهَادُ﴾

“E kur atij i thuhet: “Frikësoju Allahut”, atë e kaplon mendjemadhësia dhe e shtyn në mëkat. Atij i mjafton Xhehenemi, e sa vendbanim i keq është ai”.¹³

Muslimani e ka obligim që t'i frikësohet Allahut për obligimet që ka ndaj Tij. T'i frikësohet Allahut në raport me veten e tij. Për këtë arsye, i Dërguari – lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të – ka thënë:

¹³ El-Bekareh, 206.

قُلِ الْحَقُّ وَلَوْ عَلَىٰ نَفْسِكَ

“Thuaj të vërtetën edhe nëse është kundra vetes tënde”.

Gjithashtu, t’i frikësohet Allahut në raport me njerëzit. I Lartësuari ka thënë:

﴿وَإِذَا قُلْتُمْ فَاعْدِلُوا وَلَوْ كَانَ ذَا قُرْبَىٰ ۖ وَبِعَهْدِ اللَّهِ أَوْفُوا ۚ﴾

“E kur të flisni thoni të vërtetën edhe nëse është fjala kundra të afërmve tuaj. Dhe porosinë e Allahut plotësojeni”.¹⁴

Pra, t’i frikësohet Allahut dhe të mos flasë vetëm se me fjalë të drejtë e të saktë, t’i largohet gënjeshtërs, t’i largohet përgojimit, t’i largohet mbartjes së fjalëve, t’i largohet sharjes, ta “pastrojë” gjuhën e tij, të shtojë përmendjen e Allahut të Patëmeta e i Lartësuar. Ky është i devotshmi, i cili i frikësohet Zotit të tij dhe të pendohet nga gjynahu i tij në çdo situatë e në çdo kohë. T’i frikësohet Allahut nëse Allahu e ngarkon atë për të gjykuar midis njerëzve, nëse gjykon midis njerëzve në grindjet që kanë.

﴿وَأَنِ احْكُم بَيْنَهُم بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ﴾

“Dhe gjyko midis tyre me atë që të ka zbritur Allahu, dhe mos ndiq epshet e tyre”.¹⁵

Pra, të gjykojë midis njerëzve me atë që ka zbritur Allahu, pavarësisht a kënaqen apo zemërohen ata. Sepse ata nëse zemërohen, atëherë Allahu i Patëmeta e i Lartësuar kënaqet me të. Kështu që, ai të ketë kujdes nga Zoti i tij dhe të gjykojë me Librin e Tij dhe me Sunetin e të Dërguarit të Tij – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të*.

Kur ndodhin fitne, mosmarrëveshje dhe vështirësi, të mos flasë përveç se fjalë të mira, t’i drejtojë njerëzit tek ajo gjë që i përmirëson ata dhe çështjet e tyre. Të mos e

¹⁴ El-En’am, 152.

¹⁵ El-Maideh, 49.

ndezi fitnen me fjalët dhe nxitjet e tij apo me protestimin e tij, ashtu sikurse është gjendja sot. Ngase disa njerëz, shumë prej njerëzve, në veçanti munafikët (*hipokritët*) dhe ata të cilët kanë sëmundje në zemrat e tyre, nëse ndodhin ngjarje të ngjashme si këto, siç janë trazirat dhe fitnet, ata menjëherë aktivizohen për ndezjen e fitnes dhe nxitjen e saj midis njerëzve, si dhe zgjojnë fitne të heshtura.

Ajo që obligohet për Muslimanët në përgjithësi dhe për dijetarët dhe nxënësit e dijes në veçanti, është që ky të jetë roli i tyre: kur të ndodhin çështje të tilla si këto, të mbajnë drejtësi dhe të thonë të vërtetën, t'i qetësojnë njerëzit, të premtojnë të mirën, të paralajmërojnë nga sherri, t'i ndalojnë njerëzit nga ajo që ndez fitne dhe që shkakton armiqësi midis udhëheqësit dhe të udhëhequrve (qytetarëve), midis prijësve dhe popujve të tyre.

Në të tilla situata, Muslimanit i obligohet që të jetë i vendosur, i devotshëm dhe i pastër, i cili drejton për tek e mira dhe thërret për qetësi dhe bashkim midis Muslimanëve, thërret për mbrojtjen e gjakut dhe ruajtjen e nderit dhe të pasurisë. Atij i obligohet që ta shuajë fitnen aq sa të ketë mundësi. Kjo ka të bëjë me atë që i përfshin Muslimanët në shoqërinë e tyre, po ashtu edhe për grindjet që ndodhin midis rivalëve, midis njerëzve dhe midis individëve, ai shpejton për pajtim.

﴿لَا خَيْرَ فِي كَثِيرٍ مِّنْ نُّجُوهُمْ إِلَّا مَنَ أَمْرٌ بَصَدَقَةٌ أَوْ مَعْرُوفٌ أَوْ إِصْلَاحٌ بَيْنَ النَّاسِ وَمَنْ

يَفْعَلْ ذَلِكَ ابْتِغَاءَ مَرْضَاتِ اللَّهِ فَسَوْفَ نُؤْتِيهِ أَجْرًا عَظِيمًا﴾

“Nuk ka asgjë të mirë në shumicën e bisedave të tyre të fshehta, përveç atij i cili urdhëron për Sadaka (*lëmoshë*) apo për vepër të mirë apo për pajtim mes njerëzve. Dhe ai që e bën këtë duke kërkuar kënaqësinë e Allahut, Ne do t'i japim atij shpërblim të madh”.¹⁶

Kështu që, është obligim për të gjithë ne që të qetësohemi dhe të qetësojmë ata që janë rreth nesh, në këto ditë dhe në këto fitne të mëdha. Siç e dini, ajo që ndodh në vendet tuaja fqinje, e gjithë kjo ndodh për shkak të njerëzve të këqij, për shkak të fjalës së keqe dhe nxitjes së fitneve, në veçanti nga ata të cilët pretendojnë diturinë,

¹⁶ En-Nisa, 114.

të cilët ndezin fitne dhe nxisin për to, me qëllim që të bëhen trazira dhe të prishet rendi. Dhe kjo është prej veprave të shejtanit, sepse shejtani është ai që i nxit ata.

﴿الْمَ تَرَانَا أَرْسَلْنَا الشَّيَاطِينَ عَلَى الْكَافِرِينَ تَوْهُمْ أَزَا﴾

“A nuk e ke parë ti se Ne i kemi lëshuar shejtanët kundër mosbesimtarëve të cilët i nxisin sa më shumë për në kufër dhe mëkate”.¹⁷

Pra, obligohet për Muslimanin që kur të ndodhë ndonjë gjë prej këtyre çështjeve, qoftë çështje të përgjithshme midis Muslimanëve apo çështje midis individëve për shkak të keqkuptimeve, që të bëjë pajtim midis tyre. Madje edhe pajtimi midis dy bashkëshortëve kur ata kanë mosmarrëveshje me njëri-tjetrin, Muslimani e ka detyrë që të bëjë pajtim midis tyre dhe t'i zgjidhi marrëdhëniet e këqija ndërmjet tyre, në mënyrë që të qetësohen shtëpitë dhe të rehatohen familjet. Po ashtu, edhe midis vëllezërve dhe familjes, nëse ndodh ndonjë keqkuptim midis tyre, Muslimani e ka detyrë që të shpejtojë për pajtimin dhe bashkimin e tyre.

Pra, Muslimani e ka obligim që të ketë frikë Allahun sa të ketë mundësi në këto çështje dhe në këto situata të vështira.

I kërkoj mbrojtje Allahut nga shejtani i mallkuar:

﴿أَلَا إِنَّ أَوْلِيَاءَ اللَّهِ لَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿١٢﴾ الَّذِينَ ءَامَنُوا وَكَانُوا يَتَّقُونَ ﴿١٣﴾ لَهُمُ الْبُشْرَىٰ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَفِي الْآخِرَةِ لَا تَبْدِيلَ لِكَلِمَاتِ اللَّهِ ذَٰلِكَ هُوَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ﴿١٤﴾﴾

“Me të vërtetë për Eulijatë e Allahut (besimtarët e vërtetë, të devotshmit, të përkushtuarit në fenë e Allahut) as nuk do të kenë frikë, as nuk do të pikëllohen. Të cilët besuan dhe i frikësoheshin Allahut. Ata do të përgëzohen në këtë jetë dhe në jetën tjetër.

¹⁷ Merjem, 83.

Asnjë ndryshim nuk mund të ketë në Fjalët e Allahut. Kjo është fitorja e madhe”.¹⁸ Junus, 62-64.

Allahu na begatofte mua dhe juve me Kur'anin e Madhërishëm dhe na bëftë që të përfitojmë nga ajetet dhe përkujtimi plot urtësi që ka në të. Me kaq po e mbyll. I kërkoj falje Allahut për vete, për juve dhe të gjithë Muslimanët nga çdo gjynah. Kërkojini falje Atij dhe pendohuni tek Ai, me të vërtetë Ai është Falës i Madh dhe Mëshirues.

Hutbeja e dytë:

Lavdërimi i takon Allahut për mirësitë dhe begatitë e Tij, ne nuk mund ta lavdërojmë Atë ashtu sikurse e meriton Ai.

Ai është ashtu sikurse e ka lavdëruar Vetën e Tij. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut i Vetëm pa ortak në Rububijen (*Sundimin, krijimin, furnizimin, drejtimin e gjithësisë*), në Uluhijen (*adhurimin*), në Emrat dhe Cilësitë e Tij. Gjithashtu, dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij, si dhe njeriu më i mirë i Tij, lëvdata dhe shpëtimi i madh i Allahut qoftë mbi të, mbi familjen dhe shokët e tij, si dhe mbi ata që e pasojnë atë me të mira.

E më pas: O njerëz, frikësojuni Allahut të Lartësuar.

Kurse, pjesa tjetër e ajetit, e cila është Fjala e Tij të Lartësuar:

﴿وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا﴾

“Dhe thoni fjalë të drejta”.¹⁹

¹⁸ Junus, 62-64.

¹⁹ El-Ahzab, 70.

Fjala thuhet me gjuhë. Prandaj, o ti Musliman, ty të obligohet që të frikësohesh nga gjuha jote. Muadh ibën Xhebeli – *Allahu qoftë i kënaqur me të* – i ka thënë të Dërguarit – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* –:

A do të dënohemi ne për shkak të asaj që flasim? Ai (lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të) i tha: Mos të pastë nëna o Muadh ⁽²⁰⁾, po a nuk i hedh njerëzit me fytyrë në zjarr – apo me hundë në zjarr – përveç se e korrura e gjuhës së tyre!”.

Për këtë arsye Allahu i Patëmeta ka thënë në këtë ajet: **“Dhe thoni fjalë të drejta”**, njeriu patjetër që do të flasë, mirëpo atij i obligohet që të flasë me drejtësi. **“Dhe thoni fjalë të drejta”**, fjala e drejtë është fjala e mirë, e dobishme për vet njeriun dhe të tjerët. Është e dobishme për njeriun që të shtojë përkujtimin e Allahut. Është thënë në komentimin e këtij ajeti: **“Dhe thoni fjalë të drejta”**, se ajo (fjala e drejtë) është fjala **la ilahe il-Allah** (nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut). Kështu që, Muslimanit i obligohet që ta shtojë thënien e kësaj fjale të madhe dhe t’i shtojë lavdërimet e tij për Allahun e Patëmeta të Lartësuar.

“Dhe thoni fjalë të drejta” d.m.th të drejtë dhe kjo nënkupton ndalimin nga fjala jo e drejtë. Fjala jo e drejtë është e shumë midis njerëzve, dhe rreziku i saj është i madh. A nuk janë bërë luftërat, janë derdhur gjakrat dhe ka humbur siguria vetëm se për shkak të fjalës jo të drejtë, vetëm se për shkak të nxitjes, zemërligësisë dhe fjalës së keqe midis pushtetarit dhe të qeverisurve, si dhe midis individëve? A nuk janë derdhur gjakrat dhe janë prekur nderet, a nuk kanë humbur pasuritë, a nuk është prishur siguria përveç se për shkak të fjalës së kotë (të pavërtetë) dhe fjalës jo të drejtë? Prandaj që, t’i frikësohemi Allahut për veten tonë.

²⁰ [Shënim i përkthyesit] Shejkh Abdul-Muhsin El-Abbad – *Allahu e ruajtë* – gjatë shpjegimit të kësaj pjese të hadithit, thotë: Fjala e tij – *Lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – **“Mos të pastë nëna o Muadh”** d.m.th. të humbte nëna, derisa ajo bëhet nënë e cila ka humbur fëmijën e saj. Mirëpo këtu nuk është për qëllim lutja (kundra Muadhit – *Allahu qoftë i kënaqur me të* –), porse është për qëllim që të kihet kujdes në lidhje me atë që po i flitet atij. Madje është transmetuar se Pejgamberi – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – i ka kërkuar Zotit të tij që t’ia bëjë çdo lutje me të cilën është lutur kundra dikujt që nuk e meriton, pastrim dhe larje gjynahesh dhe afrim tek Allahu i Lartmadhërisëm për personin kundra të cilit është lutur. Kështu që, mënyra e lutjes (në pamjen e jashtme) është lutje kundra tij (Muadhit – *Allahu qoftë i kënaqur me të* –), mirëpo ajo në të vërtetë është lutje për të (Muadhin – *Allahu qoftë i kënaqur me të* –).

Burimi: Shpjegimi i “Dyzet haditheve” nga Shejkh Abdul-Muhsin El-Abbad – *Allahu e ruajtë*. Kaseta 27, minuta 38:25

Pastaj Allahu i Patëmeta e i Lartësuar sqaroi frytet që burojnë nga këto dy porosi: **“Frikësojuni Allahut dhe thoni fjalë të drejta”, “Ai jua përmirëson juve veprat tuaja dhe ju fal juve gjynahet tuaja.”** Sepse njeriu është gabimtar i madh, i cili bie shumë në mëkate. Kështu që, nëse ai thotë fjalë të drejta, siç është: përkujtimi i Allahut, kërkimi i faljes, thënia Subhan Allahu (i Patëmeta është Allahu) dhe **la ilahe il-Allah** (nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut), pendimi, si dhe thotë fjalë të drejta në raport me njerëzit, atëherë Allahu ia fal atij gjynahet e bëra. **“Dhe thoni fjalë të drejta. Ai jua përmirëson juve veprat tuaja”,** gjëja e parë **“Ai jua përmirëson juve veprat tuaja”,** ndërsa ai që thotë fjalë jo të drejtë, atëherë Allahu nuk ia përmirëson atij veprën e vet. Ashtu sikurse ka thënë i Lartmadhëruari:

﴿إِنَّ اللَّهَ لَا يُصْلِحُ عَمَلَ الْمُفْسِدِينَ﴾

“Me të vërtetë, Allahu nuk i përmirëson veprat e zullumqarëve”.²¹

Pra, fjala jo e drejtë është prishje dhe shkatërrim për njeriun, shoqërinë dhe individët. Njeriut i obligohet që të bëjë kujdes me fjalën e tij. Nëse ka për të thënë ndonjë fjalë të mirë le të flasë, e nëse nuk ka për të thënë gjë, atëherë le të heshtë. I Dërguari i Allahut – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – ka thënë:

مَنْ كَانَ يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ فَلْيَقُلْ خَيْرًا أَوْ لِيَصْمُتْ

“Kush beson Allahun dhe Ditën e Fundit, le të flasë mirë ose të heshtë”.

Njeriu nëse hesht, shpëton. Mirëpo nëse flet atëherë bëhet rob i fjalës së tij, vetëm nëse pendohet tek Allahu dhe i kërkon falje Atij. Ndërsa, nëse fjala e tij ka të bëjë me të drejtat e njerëzve, ai duhet t’u kërkojë falje atyre dhe t’u kërkojë që t’ia falin atij atë që ka thënë për ta, përndryshe ata do ta armiqësojnë atë Ditën e Gjykimit. Andaj, ne e kemi obligim që t’i frikësohemi Allahut, të Patëmeta.

“Ai jua përmirëson juve veprat tuaja”, ashtu sikurse ti përmirësove midis njerëzve me fjalën tënde të drejtë, ashtu Allahu t’i përmirëson ty veprat e tua si shpërblim në përputhje me veprat e tua. Kjo është një, ndërsa e dyta është **“dhe ju fal juve**

²¹ Junus, 81.

gjynahet tuaja”, dhe kjo është dobi e madhe, Allahu të fal ty gjynahet. Kështu që, nëse ti i frikësohesh Allahut dhe thua fjalë të drejta, Allahu t’i fal gjynahet që bën. Ky është premtim prej Allahut dhe Allahu i Patëmeta e i Lartësuar nuk e thyen premtimin e Tij.

Andaj që, ty o Musliman të obligohet që ta marrësh këtë ajet dhe ajetet e tjera si ky, rrugë mbi të cilën ecën dhe peshore me të cilën peshon gjërat, rrugë në të cilën ecën për të përmbushur obligimet që ke në raport me Allahun, në raport me veten dhe në raport me njerëzit.

Muslimanit i obligohet që t’i frikësohet Allahut dhe të thotë fjalë të drejta. Madje edhe në testament, nëse Muslimani do që të lë testament pas vdekjes së tij, le të jetë i drejtë në testament.

﴿وَلِيَخْشَ الَّذِينَ لَوْ تَرَكُوا مِنْ خَلْفِهِمْ ذُرِّيَّةً ضِعَفًا خَافُوا عَلَيْهِمْ فَلْيَتَّقُوا اللَّهَ وَلْيَقُولُوا قَوْلًا

سَدِيدًا ﴿١﴾

“Dhe le të frikësohen (për jetimët) ata të cilët (janë në pragun e vdekjes) që së shpejti do të lënë pas vetes (pas vdekjes së tyre) pasardhës (fëmijë) të dobët për të cilët kanë frikë (nga varfëria); le t’i frikësohen Allahut dhe le të thonë fjalë të drejta (pra, të sillen me jetimët që i kanë nën kujdestari ashtu siç duan që dikush tjetër të sillet me fëmijët e tyre pas vdekjes së tyre)”.²²

Tregohet i drejtë në testament dhe nuk bën padrejtësi. Padrejtësia në testament është vakëfi²³ i padrejtë e i kotë (jo i saktë).

Në një ether është transmetuar se njeriu e bën veprën e tij në formën më të mirë, pastaj kur atij i vjen vdekja, bën padrejtësi në testament dhe përfundimi i tij është në zjarr. Prandaj, Muslimanit i obligohet që t’i frikësohet Allahut gjithmonë dhe t’i

²² En-Nisa, 9.

²³ [Shënim i përkthyesit] Pronë ose pasuri që del nga pronësia e dikujt dhe jepet lëmoshë për qëllime dobiprurëse apo për qëllime bamirësie.

përmbahet fjalës së drejtë në të gjitha fjalët e tij, në të gjitha fjalët që flet, dhe të ruhet nga rrëshqitjet e gjuhës së tij.

يَمُوتُ الْفَتَى مِنْ عَشْرَةِ لِسَانِهِ

Vdes djaloshi për shkak të një rrëshqitje të gjuhës së tij

وَلَيْسَ يَمُوتُ الْمَرْءُ مِنْ عَشْرَةِ الرَّجُلِ

Dhe nuk vdes njeriu nga rrëshqitja e këmbës së tij

فَعَشْرَتُهُ مِنْ فِيهِ تُذْهَبُ نَفْسُهُ

Rrëshqitja e tij për shkak të gjuhës, ia heq kokën atij

وَعَشْرَتُهُ بِالرَّجْلِ تَبْرِي عَلَى مَهْلٍ

Ndërsa, rrëshqitja e tij për shkak të këmbës, shërohet dalëngadalë

احذر لسانك أيها الإنسان

Ruaje gjuhën tënde o ti njeri

لا يلدغك إنه ثعبان

Kurrsesi mos të të pickojë, sepse ajo është gjarpër

كم في المقابر من قتيل لسانه

Sa e sa të vrarë ka në varreza për shkak të gjuhës së tij

كانت تخاف لقائه الشجعان

E që takimin me ta e kishte frikë i guximshmi

Pra, ruaje fort gjuhën tënde o ti Musliman, dhe përkujto Fjalën e Tij të Lartësuarit: **“Dhe thoni fjalë të drejta”**, përherë dhe gjithmonë. Dhe dijeni se fjala më e mirë është Libri i Allahut, dhe se udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – dhe se punët më të këqija janë ato të shpikurat (bidatet) dhe çdo bidat është humbje. Përmbajuni xhematit se me të vërtetë Dora e Allahut është me xhematin, ndërsa ai që veçohet nga ata, ai do të veçohet në zjarr.

﴿إِنَّ اللَّهَ وَمَلَائِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا صَلُّوا عَلَيْهِ وَسَلِّمُوا تَسْلِيمًا﴾

“Me të vërtetë Allahu dhe Melaiket e Tij e lavdërojnë Pejgamberin. O ju të cilët keni besuar lutuni për të dhe përshëndeteni atë me selam”.²⁴

O Allah, lavdëroje, shpëtoje dhe bekoje Pejgamberin tonë, Muhamedin dhe qofsh i kënaqur o Allah me katër prijësat, Imamët e udhëzuar: Ebu Bekrin, Umerin, Uthmanin dhe Aliun dhe me të gjithë Sahabët dhe Tabi’inët, si dhe me ata të cilët i pasojnë ata me të mira deri në Ditën e Gjykimit.

O Allah. Forcoje Islamin dhe Muslimanët. Poshtëroje shirkun dhe ata të cilët bëjnë shirk (*idhujtarët*). Bashkoi Muslimanët në fe.

O Allah na e përmirëso fenë tonë me të cilën ruhet gjendja jonë dhe na e përmirëso dunjanë tonë në të cilën është jeta jonë. Na e përmirëso jetën tjetër tek e cila është kthimi ynë. Na e prano pendimin, na fal dhe na mëshiro.

O Allah përmirësoi prijësit tanë dhe bëji ata drejtues të udhëzuar, jo të humbur e as që i çojnë në humbje të tjerët.

O Allah përmirësoji nijetet, shoqëruesit dhe këshilltarët e tyre. Largo prej tyre njerëzit e këqij dhe zullumqarët o Zot i botëve.

²⁴ El-Ahzab, 56.

O Allah përmirësoje gjendjen e Muslimanëve në çdo vend. Ruaji ata nga sherri i armiqve të tyre, siç janë kufarët (*mosbesimtarët*), munafikët (*hipokritët*), idhujtarët dhe të gjithë zullumqarët e tjerë o Zot i botëve.

O Zoti ynë na i prano neve lutjet, vërtet Ti je Gjithëdhëguesi i Gjithëdituri.

O robër të Allahut!

﴿إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ وَإِيتَايَ ذِي الْقُرْبَىٰ وَيَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ

وَالْبَغْيِ يَعِظُكُمْ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ ﴿٥٦﴾ وَأَوْفُوا بِعَهْدِ اللَّهِ إِذَا عَاهَدْتُمْ وَلَا تَنْقُضُوا الْأَيْمَانَ

بَعْدَ تَوْكِيدِهَا وَقَدْ جَعَلْتُمُ اللَّهَ عَلَيْكُمْ كَفِيلًا إِنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ مَا تَفْعَلُونَ ﴿٥٧﴾﴾

“Më të vërtetë Allahu urdhëron për drejtësi dhe bamirësi, për dhënie të afërmve, si dhe ndalon veprat e shëmtuara, të keqen dhe dhunën. Ju këshillon në mënyrë që ju të përkujtoni. Dhe përmbushni Besën e dhënë Allahut kur ta keni dhënë atë dhe mos i thyeni betimet pasi t’i keni dhënë. Dhe tashmë ju keni zgjedhur Allahun Mbikëqyrës mbi juve. Vërtet që Allahu di gjithçka që ju veproni”.²⁵

Përkujtojeni Allahun se pastaj Ai ju përkujton juve dhe falenderojeni për begatitë e Tij dhe Ai do t’jua shtojë juve. E me të vërtetë përmendja e Allahut është më e madhja. Allahu di se çfarë bëni ju.

Burimi: <http://www.alfawzan.af.org.sa/node/13320>

Përktheu: Altin Dallashi

18 Xhumadal-ula 1436 / 9 Mars 2015

²⁵ En-Nahl, 90-91.